



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Avokatura Shtetërore-DrzhavnoPravobranilastvo – StateAdvocacy Office

Nr. 52 /2026
Datë: 23.06/2026

Në mbështetje të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtar, Nr.7/01 mars 2019), dhe në përputhje me nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ushtruesja e detyrës së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr.45/2026

1. Shfuqizohet Vendimi Nr.45/2026 i datës 12.05.2026 për pezullimin nga marrëdhënia e punës të znj. Nexhmije Karaqi, Avokate Shtetërore në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, znj. Karaqi rikthehet në pozitën e mëparshme të punës.
3. Obligohet Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë 12.05.2026 znj. Nexhmije Karaqi, Avokate Shtetërore në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës është pezulluar sipas detyrës zyrtare në pajtim me paragrafin 1.6 të nenit 69 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik.

Më datën 09.06.2026, avokati Flamur Bllacaku, përmes shkresës zyrtare, ka kërkuar që znj. Nexhmije Karaqi të rikthehet në vendin e punës, pasi që ndaj saj më datën 05.06.2026 është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak dhe i njëjta tashmë mbrohet në liri.

Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi, Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë me kërkesë për konfirmimin e statusit të masës së arrestit shtëpiak ndaj znj. Nexhmije Karaqi.

Më datën 22.06.2026, nga Gjykata Themelore në Prishtinë është pranuar njoftimi zyrtar, me të cilin konfirmohet se nuk është paraqitur ankesë brenda afatit ligjor kundër Aktvendimit me të cilin hedhet si jolëndore kërkesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS/nr.219/2026 e datës 01.06.2026, për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak, ndaj të pandehurës znj. Nexhmije Karaqi, praktikisht Aktvendimi në fjalë ka marrë formën e prerë.

Bazuar në rrethanat e sipërpërmendura dhe dokumentacionin zyrtar të pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fitore GAJTANI

Ushtruese e detyrës së Avokatit
të Përgjithshëm Shtetëror

Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj.Nexhmije Karaqi;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizioni për Burime Njerëzore dhe*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*